

ZGJIDHJA E EKUACIONIT TË GRADËS 5-TË

ELIRA SHASKA

ABSTRACT. Ekuacioni polinomial $f(x) = 0$ ka zgjidhje me radikale atëherë dhe vetëm atëherë kur grupi i Galuait $\text{Gal}_{\mathbb{F}}(f)$ është grup i zgjidhshëm. Ne japim kushte të nevojshme dhe të mjaftueshme për përcaktimin e $\text{Gal}_{\mathbb{F}}(f)$ dhe në rastet kur $\text{Gal}_{\mathbb{F}}(f)$ është grup i zgjidhshëm japim formulat përkatëse të gjetjes së rrënjëve.

1. HYRJE

Gjetja e formulave për rrënjët e ekuacioneve polinomialë është një nga problemet më klasike të matematikës. Formula kuadratike (për gjetjen e rrënjëve të polinomeve kuadratike) është nga formulat e para të algjebres. Për polinome me gradë $n = 3$ (kubiket) këto formula janë disi më të komplikuar dhe njihen si formulat e Kardanos. Për $n = 4$ (kuartiket) formulat e gjetjes së rrënjëve quhen formulat e Ferrarit; shih [Sha20] për më tepër detaje.

Ekuacionet e gradës $n \geq 5$ (kuintiket) paraqitën vështiresi më të mëdha. Në 1799 Ruffini paraqiti një "vërtetim të pasaktë" të faktit se nuk ekziston një formulë për zgjidhjen e ekuacionit kuintik. Në 1824, Nils Abel ishte i pari që dha një vërtetim të saktë të faktit që një formulë e gjetjes së rrënjëve për kuintiket nuk ekziston. Këtij fakti tashmë në literaturë i referohet si teorema Abel-Ruffini; shihni [Kin96].

Me zhvillimin e Teorisë së Galuait, teoria a gjetjes së formulave që përcaktojnë rrënjët (zgjidhjet me radikale) u transformua dhe u përgjithësua për polinomet me gradë cfarëdo. Rezultati kryesor i Teorisë së Galuait është : një ekuacion polinomial $f(x) = 0$, për $f \in \mathbb{F}[x]$, është i zgjidhshëm me radikale atëherë dhe vetëm atëherë kur $\text{Gal}_{\mathbb{F}}(f)$ është një grup i zgjidhshëm. Natyrshëm lind pyetja: cilat janë formulat për ekuacionet kuintike që janë të zgjidhshme?

Në këtë përmbledhje të disa fakteve bazë mbi teorinë e zgjidhjeve të ekuacioneve ne synojmë të japim një përshkrim të shkurtër të zgjidhjes së ekuacioneve kuintike. Ne supozojmë se lexuesi është i familiarizuar me faktet bazë të algjebres në nivelin e [Sha20]

2. NJOHURI PARAPRAKE

Le të jetë \mathbb{F} një fushë perfekte me karakteristike $\text{char } \mathbb{F} = 0$. Jepet $f(x) \in \mathbb{F}[x]$ një polinom me gradë n dhe $\alpha_1, \dots, \alpha_n$ rrënjët e këtij polinomi. Fusha $\mathbb{F}(\alpha_1, \dots, \alpha_n)$ quhet **fusha ndarëse** e polinomit $f(x)$. Nga një teoremë e Kronecker, për çdo fushë \mathbb{F} dhe çdo polinom $f(x) \in \mathbb{F}[x]$ ekziston një shtrirje E_f e \mathbb{F} -së që është fusha ndarëse e $f(x)$.

Teorema 1 (Teorema e shtrirjes së izomorfizmit). *Le të jetë $\sigma : \mathbb{F} \rightarrow \mathbb{F}'$ një izomorfizëm i fushës. Kemi $S = \{f_i(x)\}$ një bashkësi polinomesh në \mathbb{F} dhe $S' = \{\sigma(f_i)\}$ polinomet korresponduese në \mathbb{F}' . Le të jetë K fusha ndarëse për S mbi \mathbb{F} dhe K' fusha ndarëse S' mbi \mathbb{F}' . Atëherë ekziston një automorfizëm $\tau : K \rightarrow K'$ me $\tau|_{\mathbb{F}} = \sigma$.*

Për më shumë, nëse $\alpha \in K$ dhe α' është një rrënjë e polinomit $\sigma(\min(\alpha, \mathbb{F}, x))$, atëherë τ mund të zgjidhet i tillë që $\tau(\alpha) = \alpha'$.

Pra, për çdo $f(x) \in \mathbb{F}[x]$ çdo dy fusha ndarëse të $f(x)$ -së janë \mathbb{F} -izomorfike.

Date: March 15, 2021.

2000 *Mathematics Subject Classification*. Primary 20F70, 14H10; Secondary 14Q05, 14H37.

Key words and phrases. invariants, binary forms, quintic.

Supported by A^2G^2 -group at RISAT.

Lema 1. Fusha ndarëse e një polinomi me gradë n mbi \mathbb{F} ka gradë $[E_f : \mathbb{F}] \leq n!$. Në qoftë se $f(x)$ është i pathjeshtueshëm mbi \mathbb{F} , atëherë $n \mid [E_f : \mathbb{F}]$.

Teorema 2. Le të jetë $f \in \mathbb{F}[x]$ dhe E_f fusha ndarëse mbi \mathbb{F} . Nëse $f(x)$ nuk ka rrënjë të shumëfishta, atëherë

$$(1) \quad |\text{Gal}(E_f/\mathbb{F})| = [E_f : \mathbb{F}].$$

2.1. **Grupi Galua i polinomeve.** Jepet polinomi $f(x)$ me gradë $n = \deg f$, i pafaktorizueshëm në $\mathbb{F}[x]$, i cili faktorizohet si

$$(2) \quad f(x) = (x - \alpha_1) \dots (x - \alpha_n)$$

në fushën ndarëse E_f . Ateherë, E_f/\mathbb{F} është shtrirje Galua sepse është shtrirje normale (E_f është fushë ndarëse) dhe shtrirje e ndashme (sepse \mathbb{F} është fushë perfekte). Grupi $\text{Gal}(E_f/\mathbb{F})$ quhet **grupi i Galuait** i $f(x)$ mbi \mathbb{F} dhe shënohet me $\text{Gal}_{\mathbb{F}}(f)$. Elementët e $\text{Gal}_{\mathbb{F}}(f)$ përkëmbejnë rrënjët e $f(x)$. Pra grupi i Galuait i një polinomi ka një kopje izomorfike në S_n , e cila përcaktohet deri në klasën e konjugimit nga $f(x)$

Pohim 1. Dy pohimet e mëposhtme janë të vërteta:

- (i) Shënojmë me $G = \text{Gal}_{\mathbb{F}}(f)$ dhe $H = G \cap A_n$. Atëherë $H = \text{Gal}(E_f/\mathbb{F}(\sqrt{\Delta_f}))$. Për më tepër, G është një nëngrup i grupit alternativ A_n atëherë dhe vetëm atëherë kur diskriminanti Δ_f është një katror i plotë në \mathbb{F} .
- (ii) Faktorët e pazbërthueshëm të f në $\mathbb{F}[x]$ korrespondojnë me orbitat e G -së. Për më tepër, G është një nëngrup transitiv i S_n atëherë dhe vetëm atëherë kur f është i pathjeshtueshëm.

Për vërtetimin e këtyre fakteve shihni [Sha20].

3. ZGJIDHJA E EKUACIONEVE POLINOMIALË TË GRADËS SË 5-TË

Lema 2. Le të jetë $f(x) \in \mathbb{F}[x]$ një polinom i pathjeshtueshëm i gradës së pestë. Atëherë $\text{Gal}_{\mathbb{F}}(f)$ është izomorfik me një nga këta grupe: $C_5, D_5, F_5 = \text{AGL}(1, 5), A_5$, or S_5

Proof. G është transitiv, prandaj nëngrupi i tij Sylow-5 është izomorfik me C_5 (i gjeneruar nga një cikël i rendit 5). Nëse C_5 është normal, atëherë G ka të paktën 6 nëngrupe Sylow-5; atëherë $|G| \geq 6 \cdot 5 = 30$, prandaj $[S_5 : G] \leq 4$ nga ku rrjedh $G = S_5, A_5$. Nëse C_5 është normal në G atëherë G është i konjuguar ose C_5, D_5 (grupi dihedral i rendit 10) ose $F_5 = \text{AGL}(1, 5)$, normalizuesi i plotë i C_5 në S_5 , i rendit 20 (i quajtur edhe grupi Frobenius i rendit 20). \square


Shënim 1. Nëse dallori i polinomit të gradës së pestë është katror i plotë në \mathbb{F} atëherë $\text{Gal}(f)$ përmbahet në A_5 . Kjo do të thotë që është C_5, D_5 , ose A_5 .

3.1. **Kuintikët e zgjidhshëm.** Nëse $G = S_5, A_5$ atëherë ekuacioni $f(x) = 0$ nuk është i zgjidhshëm me radikale. Ne duam të shqyrtojmë këtu rastin $G \not\cong S_5, A_5$.


Le të jetë $f(x)$ një polinom i pathjeshtueshëm i gradës së pestë në $\mathbb{F}[x]$ i dhënë në formën:

$$(5) \quad f(x) = x^5 + c_4x^4 + \dots + c_0 = (x - \alpha_1) \dots (x - \alpha_5)$$

Le të jetë $G = \text{Gal}(f)$, nëngrup transitiv S_5 i përfshuar nga përkëmbimi i rrënjëve të ndryshme $\alpha_1, \dots, \alpha_5$. Si më parë $E_f = k(\alpha_1, \dots, \alpha_5)$ përfaqëson fushën ndarëse të f -së. Një element 5-ciklor në $S_5 = \text{Sym}(\{1, \dots, 5\})$ i korrespondon një pentagoni (të orientuar) me kulme $1, \dots, 5$. Një 5-cikël dhe inversi i tij korrespondojnë me një pentagon të pa orientuar.



Kurse gjithë grupi ciklik C_5 i korrespondon pentagonit së bashku me "të kundërtin e tij".



F_5 është normalizuesi i C_5 në S_5 dhe përkëmben pentagonin me të kundërtin e tij. D_5 është nëngrupi i F_5 që fikson pentagonin (grupi i simetrisë së pentagonit) dhe C_5 nëngrupi i rrotullimeve. Për shembull, F_5 gjenerohet nga

$$(3) \quad F_5 = \langle \sigma, \tau \mid \sigma^5 = \tau^4 = (\sigma\tau)^4 = \sigma\sigma\tau\sigma^{-1}\tau^{-1} \rangle,$$

ku $\sigma = (12345)$ and $\tau = (2453)$. Pra në se $G \leq F_5$ atëherue G fikson

$$(4) \quad \delta_1 = (\alpha_1 - \alpha_2)^2(\alpha_2 - \alpha_3)^2(\alpha_3 - \alpha_4)^2(\alpha_4 - \alpha_5)^2(\alpha_5 - \alpha_1)^2 - (\alpha_1 - \alpha_3)^2(\alpha_3 - \alpha_5)^2(\alpha_5 - \alpha_2)^2(\alpha_2 - \alpha_4)^2(\alpha_4 - \alpha_1)^2$$

ku termi i parë (respektivisht termi i dytë) korrespondon me brinjët e pentagonit (respektivisht pentagonit të kundërt).

Janë gjashtë nëngrupe 5-Sylow të S_5 që jepen si më poshtë

- $H_1 = \langle (1, 2, 3, 4, 5) \rangle = \{(), (1, 2, 3, 4, 5), (1, 3, 5, 2, 4), (1, 4, 2, 5, 3), (1, 5, 4, 3, 2)\}$
- $H_2 = \langle (1, 2, 3, 5, 4) \rangle = \{(), (1, 2, 3, 5, 4), (1, 3, 4, 2, 5), (1, 5, 2, 4, 3), (1, 4, 5, 3, 2)\}$
- $H_3 = \langle (1, 2, 4, 5, 3) \rangle = \{(), (1, 2, 4, 5, 3), (1, 4, 3, 2, 5), (1, 5, 2, 3, 4), (1, 3, 5, 4, 2)\}$
- $H_4 = \langle (1, 2, 4, 3, 5) \rangle = \{(), (1, 2, 4, 3, 5), (1, 4, 5, 2, 3), (1, 3, 2, 5, 4), (1, 5, 3, 4, 2)\}$
- $H_5 = \langle (1, 2, 5, 3, 4) \rangle = \{(), (1, 2, 5, 3, 4), (1, 5, 4, 2, 3), (1, 3, 2, 4, 5), (1, 4, 3, 5, 2)\}$
- $H_6 = \langle (1, 3, 4, 5, 2) \rangle = \{(), (1, 3, 4, 5, 2), (1, 4, 2, 3, 5), (1, 5, 2, 4, 3), (1, 5, 3, 2, 4)\}$

Për të gjetur gjithë invariantet për ccdo group H_i , $i = 1, \dots, 6$ ne konsiderojmë polinomin $f(x)$ si një formë binare $f(x, y)$.

3.2. Format binare dhe invariantët e tyre. Një **formë binare** është një polinom homogjen $f(x, y)$ me gradë $d \geq 2$; shih [SS16] për një përshkrim të formave kuadratike në literaturën Shqip dhe [Gey74, Hil93] për format binare të gradës $d > 2$. Le të jetë \mathbb{F} një fushë dhe $V_d(\mathbb{F})$ hapësira e formave binare $f(x, y)$ me gradë $d \geq 2$ dhe koeficientë në \mathbb{F} . $V_d(\mathbb{F})$ është një hapësirë vektoriale mbi \mathbb{F} . Grupi $\text{GL}_2(\mathbb{F})$ vepron mbi $V_d(\mathbb{F})$ si në vazhdim:

$$\begin{aligned} \text{GL}_2(k) \times V_d &\rightarrow V_d \\ \left(\begin{bmatrix} a & b \\ c & d \end{bmatrix}, f(x, y) \right) &\rightarrow f(ax + by, cx + dy) \end{aligned}$$

Ne do të shënojmë $f(ax + by, cx + dy)$ me f^M . Dy forma binare quhen **ekuivalente** kur janë në të njëjtën orbitë të këtij veprimi.

Le të marrim tani një formë binare $f \in \mathbb{F}[x, y]$ me gradë n . Mbi mbylljen algjebrike $\bar{\mathbb{F}}$ të \mathbb{F} -së, kjo formë faktorizohet si më poshtë

$$f(x, y) = b_n x^n + b_{n-1} x^{n-1} y + \dots + b_0 y^n = (\beta_1 x - \gamma_1 y) \cdots (\beta_n x - \gamma_n y)$$

ku $\beta_i, \gamma_i \in \bar{\mathbb{F}}$. Vërtetimi i këtij fakti mund të shihet lehtë si më poshtë. Supozojmë se $b_n \neq 0$. (Në qoftë se $b_n = 0$ përdorim induksionin mbi f/y). Atëherë kemi

$$f(x, y) = b_n y^n \left(\left(\frac{x}{y} \right)^n + \frac{b_{n-1}}{b_n} \left(\frac{x}{y} \right)^{n-1} + \dots + \frac{b_0}{b_n} \right) = b_n y^n \left(\frac{x}{y} - \alpha_1 \right) \cdots \left(\frac{x}{y} - \alpha_n \right)$$

për disa $\alpha_i \in \bar{\mathbb{F}}$. Vini re se cdo faktor mund të shkruhet si

$$(\beta_i x - \gamma_i y) = \det \begin{bmatrix} x & y \\ \gamma_i & \beta_i \end{bmatrix}$$

Pra,

$$f = \det \begin{bmatrix} x & y \\ \gamma_1 & \beta_1 \end{bmatrix} \cdots \det \begin{bmatrix} x & y \\ \gamma_n & \beta_n \end{bmatrix}$$

Veprimi i grupit $\text{GL}_2(\mathbb{F})$ mbi $V_n(\mathbb{F})$ për cdo $M \in \text{GL}_2(\mathbb{F})$,

$$M = \begin{bmatrix} a & b \\ c & d \end{bmatrix}$$

dërgon formën binare f tek

$$f^M := f(ax + by, cx + dy) = (\beta'_1 x - \gamma'_1 y) \cdots (\beta'_n x - \gamma'_n y).$$

Pra kemi

$$(\gamma'_i, \beta'_i) = (\gamma_i, \beta_i) M^{-1} \det(M)$$

Versioni projektiv i δ_1 është $\tilde{\delta}_1$, që formohet duke zëvendësuar $\alpha_i - \alpha_j$ me

$$(5) \quad D_{ij} = \det \begin{bmatrix} \gamma_i & \beta_i \\ \gamma_j & \beta_j \end{bmatrix}$$

në formulat që përkufizojnë δ_i , $i = 1, \dots, 6$.

$$(6) \quad \tilde{\delta}_1 = D_{12}^2 D_{23}^2 D_{34}^2 D_{45}^2 D_{51}^2 - D_{13}^2 D_{35}^2 D_{52}^2 D_{24}^2 D_{41}^2$$

Meqënëse S_5 ka gjashtë 5-Sylow nëngrupe, shënojmë me $\delta_1, \dots, \delta_6$ elementët përkatës të këtyre nëngrupeve. Këto elementë janë

$$(7) \quad \begin{aligned} \tilde{\delta}_2 &= D_{12}^2 D_{23}^2 D_{35}^2 D_{54}^2 D_{41}^2 - D_{13}^2 D_{34}^2 D_{42}^2 D_{25}^2 D_{51}^2 \\ \tilde{\delta}_3 &= D_{12}^2 D_{24}^2 D_{45}^2 D_{53}^2 D_{31}^2 - D_{14}^2 D_{43}^2 D_{32}^2 D_{25}^2 D_{51}^2 \\ \tilde{\delta}_4 &= D_{12}^2 D_{24}^2 D_{43}^2 D_{35}^2 D_{51}^2 - D_{14}^2 D_{45}^2 D_{52}^2 D_{23}^2 D_{31}^2 \\ \tilde{\delta}_5 &= D_{12}^2 D_{25}^2 D_{53}^2 D_{34}^2 D_{41}^2 - D_{15}^2 D_{54}^2 D_{42}^2 D_{23}^2 D_{31}^2 \\ \tilde{\delta}_6 &= D_{13}^2 D_{34}^2 D_{45}^2 D_{52}^2 D_{21}^2 - D_{14}^2 D_{42}^2 D_{23}^2 D_{35}^2 D_{51}^2 \end{aligned}$$

Lema 3. $\delta_i^\sigma = \delta_i$ dhe $\delta_i^\tau = \delta_i$ për $i = 1, \dots, 6$.

G përkëmben $\delta_1, \dots, \delta_6$. Nëse G është i konjuguar me një nëngrup të F_5 , atëherë fikson një nga $\delta_1, \dots, \delta_6$. Pikërisht elementi δ_i që fiksohet duhet të jetë në \mathbb{F} . Pra, kusht i nevojshëm dhe i mjaftueshëm që një polinom i pathjeshtueshëm $f(x)$ të jetë i zgjidhshëm me radikale është që një nga δ_i të jetë në \mathbb{F} , ose me fjalë të tjera polinomi

$$(8) \quad g(x) = (x - \delta_1) \cdots (x - \delta_6) \in \mathbb{F}[x]$$

të ketë një rrënjë në \mathbb{F} , ku δ_1 jepet në Eq. (4) dhe $\delta_2, \dots, \delta_6$ si më poshtë:

$$(9) \quad \begin{aligned} \delta_2 &= (\alpha_1 - \alpha_2)^2 (\alpha_2 - \alpha_3)^2 (\alpha_3 - \alpha_5)^2 (\alpha_5 - \alpha_4)^2 (\alpha_4 - \alpha_1)^2 \\ &\quad - (\alpha_1 - \alpha_3)^2 (\alpha_3 - \alpha_4)^2 (\alpha_4 - \alpha_2)^2 (\alpha_2 - \alpha_5)^2 (\alpha_5 - \alpha_1)^2 \\ \delta_3 &= (\alpha_1 - \alpha_2)^2 (\alpha_2 - \alpha_4)^2 (\alpha_4 - \alpha_5)^2 (\alpha_5 - \alpha_3)^2 (\alpha_3 - \alpha_1)^2 \\ &\quad - (\alpha_1 - \alpha_4)^2 (\alpha_4 - \alpha_3)^2 (\alpha_3 - \alpha_2)^2 (\alpha_2 - \alpha_5)^2 (\alpha_5 - \alpha_1)^2 \\ \delta_4 &= (\alpha_1 - \alpha_2)^2 (\alpha_2 - \alpha_4)^2 (\alpha_4 - \alpha_3)^2 (\alpha_3 - \alpha_5)^2 (\alpha_5 - \alpha_1)^2 \\ &\quad - (\alpha_1 - \alpha_4)^2 (\alpha_4 - \alpha_5)^2 (\alpha_5 - \alpha_2)^2 (\alpha_2 - \alpha_3)^2 (\alpha_3 - \alpha_1)^2 \\ \delta_5 &= (\alpha_1 - \alpha_2)^2 (\alpha_2 - \alpha_5)^2 (\alpha_5 - \alpha_3)^2 (\alpha_3 - \alpha_4)^2 (\alpha_4 - \alpha_1)^2 \\ &\quad - (\alpha_1 - \alpha_5)^2 (\alpha_5 - \alpha_4)^2 (\alpha_4 - \alpha_2)^2 (\alpha_2 - \alpha_3)^2 (\alpha_3 - \alpha_1)^2 \\ \delta_6 &= (\alpha_1 - \alpha_3)^2 (\alpha_3 - \alpha_4)^2 (\alpha_4 - \alpha_5)^2 (\alpha_5 - \alpha_2)^2 (\alpha_2 - \alpha_1)^2 \\ &\quad - (\alpha_1 - \alpha_4)^2 (\alpha_4 - \alpha_2)^2 (\alpha_2 - \alpha_3)^2 (\alpha_3 - \alpha_5)^2 (\alpha_5 - \alpha_1)^2 \end{aligned}$$

Teorema 3. Në qoftë se G fikson një δ_i atëherë G është i konjuguar me një nëngrup të F_5 , kur $\delta_1, \dots, \delta_6$ janë të ndryshme.

Proof. Për të vërtetuar këtë mjafton të vërtetojmë se $\delta_1, \dots, \delta_6$ janë dy nga dy të ndryshme kur $\Delta_f \neq 0$. Pra duhet të vërtetojmë se $\Delta_f \neq 0 \implies \Delta_g \neq 0$. Duke përdorur algjebren kompjutacionale ne mund të gjejmë diskriminantin Δ_g e $g(x)$ dhe shohim se $\frac{\Delta_g}{\Delta_f}$ është një polinom si më poshtë

$$\Delta_g = ((\alpha_1 - \alpha_2)(\alpha_3 - \alpha_4)(\alpha_4 - \alpha_5)(\alpha_3 - \alpha_5))^4 \cdot \Delta_f \cdot I_2^2 \cdot I_3 \cdot I_4^2 \cdot I_6^2$$

ku I_2, I_3, I_4 , dhe I_6 janë dhënë në ???. Kjo përfundon vërtetimin. □

Koeficientët e $g(x)$ janë funksione simetrike në $\alpha_1, \dots, \alpha_5$, prandaj janë shprehje polinomiale c_0, \dots, c_4 . Qëllimi ynë është të gjejmë këto shprehje. Kjo do na japë një kriter për të kontrolluar nëse $f(x) = 0$ është i zgjidhshëm me radikale.


Lema 4. Le të jetë $s_r(x_1, \dots, x_6)$, $r = 1, \dots, 6$, polinomi simetrik elementar

$$(10) \quad s_r = \sum_{i_1 < i_2 < \dots < i_r} x_{i_1} x_{i_2} \dots x_{i_r}.$$

Atëherë

$$(11) \quad d_r := s_r(\tilde{\delta}_1, \dots, \tilde{\delta}_6)$$

është një shprehje polinomiale homogjene në b_0, \dots, b_5 e gradës $4r$. Këto polinomeve janë invariante nën veprimin e $SL_2(\mathbb{F})$ në kuantikët binare: Për cdo $M \in SL_2(\mathbb{F})$ kuantikun f^M ka të shoqëruar të njëjtin d_r .



Proof. Për cdo $\alpha_j := \gamma_j/\beta_j$ kemi

$$\tilde{\delta}_i = (\beta_1 \cdots \beta_5)^4 \delta_i = b_5^4 \cdot \delta_i.$$

Pra $d_r = b_5^{4r} s_r(\delta_1, \dots, \delta_6)$. Meqënëse $s_r(\delta_1, \dots, \delta_6)$ janë shprehje polinomiale në $c_j = \frac{b_j}{b_5}$, për $j = 0, \dots, 4$, atëherë d_r është funksion racional në b_0, \dots, b_5 , ku numëruesi është një fuqi e b_5 . Duke këmbyer rolet e x me y kemi që edhe emëruesi është një fuqi e b_0 . Kjo do të thotë që është konstante, i.e., d_r është një polinom në b_0, \dots, b_5 . Nëse zevëndësojmë secilin β_j me $c\beta_j$ për një skalar λ atëherë secili $\tilde{\delta}_i$ do të shumëzohet me λ^4 , kështu d_r do të shumëzohet me λ^{4r} . Prandaj d_r është homogjen i gradës $4r$. Pjesa tjetër është e qartë. \square

$$\begin{aligned} I_2 = & (\alpha_1\alpha_3 + \alpha_1\alpha_4 - 2\alpha_1\alpha_5 - 2\alpha_3\alpha_4 + \alpha_3\alpha_5 + \alpha_4\alpha_5) (2\alpha_2\alpha_3 - \alpha_2\alpha_4 - \alpha_2\alpha_5 - \alpha_3\alpha_4 - \alpha_3\alpha_5 + 2\alpha_4\alpha_5) \\ & (\alpha_2\alpha_3 - 2\alpha_2\alpha_4 + \alpha_2\alpha_5 + \alpha_3\alpha_4 - 2\alpha_3\alpha_5 + \alpha_4\alpha_5) (2\alpha_1\alpha_2 - \alpha_1\alpha_4 - \alpha_1\alpha_5 - \alpha_2\alpha_4 - \alpha_2\alpha_5 + 2\alpha_4\alpha_5) \\ & (\alpha_1\alpha_3 - 2\alpha_1\alpha_4 + \alpha_1\alpha_5 + \alpha_3\alpha_4 - 2\alpha_3\alpha_5 + \alpha_4\alpha_5) (\alpha_2\alpha_3 + \alpha_2\alpha_4 - 2\alpha_2\alpha_5 - 2\alpha_3\alpha_4 + \alpha_3\alpha_5 + \alpha_4\alpha_5) \\ & (2\alpha_1\alpha_3 - \alpha_1\alpha_4 - \alpha_1\alpha_5 - \alpha_3\alpha_4 - \alpha_3\alpha_5 + 2\alpha_4\alpha_5) (2\alpha_1\alpha_2 - \alpha_1\alpha_3 - \alpha_1\alpha_5 - \alpha_2\alpha_3 - \alpha_2\alpha_5 + 2\alpha_3\alpha_5) \\ & (2\alpha_1\alpha_2 - \alpha_1\alpha_3 - \alpha_1\alpha_4 - \alpha_2\alpha_3 - \alpha_2\alpha_4 + 2\alpha_3\alpha_4) \end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
I_3 = & (\alpha_1\alpha_2\alpha_3 - \alpha_1\alpha_2\alpha_5 - 2\alpha_1\alpha_3\alpha_4 + \alpha_1\alpha_3\alpha_5 + \alpha_1\alpha_4^2 - \alpha_2\alpha_3\alpha_5 - \alpha_2\alpha_4^2 + 2\alpha_2\alpha_4\alpha_5 + \alpha_3\alpha_4^2 - \alpha_4^2\alpha_5)^2 \\
& (\alpha_1\alpha_2\alpha_4 - \alpha_1\alpha_2\alpha_5 - \alpha_1\alpha_3^2 + 2\alpha_1\alpha_3\alpha_5 - \alpha_1\alpha_4\alpha_5 + \alpha_2\alpha_3^2 - 2\alpha_2\alpha_3\alpha_4 + \alpha_2\alpha_4\alpha_5 + \alpha_3^2\alpha_4 - \alpha_3^2\alpha_5)^2 \\
& (\alpha_1\alpha_2\alpha_3 - \alpha_1\alpha_2\alpha_4 + \alpha_1\alpha_3\alpha_4 - 2\alpha_1\alpha_3\alpha_5 + \alpha_1\alpha_5^2 - \alpha_2\alpha_3\alpha_4 + 2\alpha_2\alpha_4\alpha_5 - \alpha_2\alpha_5^2 + \alpha_3\alpha_5^2 - \alpha_4\alpha_5^2)^2 \\
& (\alpha_1\alpha_2\alpha_4 - \alpha_1\alpha_2\alpha_5 + \alpha_1\alpha_3^2 - 2\alpha_1\alpha_3\alpha_4 + \alpha_1\alpha_4\alpha_5 - \alpha_2\alpha_3^2 + 2\alpha_2\alpha_3\alpha_5 - \alpha_2\alpha_4\alpha_5 + \alpha_3^2\alpha_4 - \alpha_3^2\alpha_5)^2 \\
& (\alpha_1\alpha_2\alpha_3 - \alpha_1\alpha_2\alpha_4 - \alpha_1\alpha_3\alpha_4 + 2\alpha_1\alpha_4\alpha_5 - \alpha_1\alpha_5^2 + \alpha_2\alpha_3\alpha_4 - 2\alpha_2\alpha_3\alpha_5 + \alpha_2\alpha_5^2 + \alpha_3\alpha_5^2 - \alpha_4\alpha_5^2)^2 \\
& (\alpha_1\alpha_2\alpha_3 - \alpha_1\alpha_2\alpha_5 - \alpha_1\alpha_3\alpha_5 - \alpha_1\alpha_4^2 + 2\alpha_1\alpha_4\alpha_5 - 2\alpha_2\alpha_3\alpha_4 + \alpha_2\alpha_3\alpha_5 + \alpha_2\alpha_4^2 + \alpha_3\alpha_4^2 - \alpha_4^2\alpha_5)^2 \\
& (\alpha_1\alpha_2\alpha_3 - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_4 + \alpha_1\alpha_2\alpha_5 - \alpha_1\alpha_3\alpha_5 + \alpha_1\alpha_4^2 - \alpha_2\alpha_3\alpha_5 + \alpha_2\alpha_4^2 - \alpha_3\alpha_4^2 + 2\alpha_3\alpha_4\alpha_5 - \alpha_4^2\alpha_5)^4 \\
& (\alpha_1\alpha_2\alpha_3 + \alpha_1\alpha_2\alpha_4 - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_5 - \alpha_1\alpha_3\alpha_4 + \alpha_1\alpha_5^2 - \alpha_2\alpha_3\alpha_4 + \alpha_2\alpha_5^2 + 2\alpha_3\alpha_4\alpha_5 - \alpha_3\alpha_5^2 - \alpha_4\alpha_5^2)^4 \\
& (2\alpha_1\alpha_2\alpha_3 - \alpha_1\alpha_2\alpha_4 - \alpha_1\alpha_2\alpha_5 - \alpha_1\alpha_3^2 + \alpha_1\alpha_4\alpha_5 - \alpha_2\alpha_3^2 + \alpha_2\alpha_4\alpha_5 + \alpha_3^2\alpha_4 + \alpha_3^2\alpha_5 - 2\alpha_3\alpha_4\alpha_5)^4
\end{aligned}$$

$$\begin{aligned}
I_4 = & (\alpha_1^2\alpha_2^2 - 2\alpha_1^2\alpha_2\alpha_5 + \alpha_1^2\alpha_4^2 - 2\alpha_1^2\alpha_4\alpha_5 + 2\alpha_1^2\alpha_5^2 - 2\alpha_1\alpha_2^2\alpha_4 - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_4^2 + 8\alpha_1\alpha_2\alpha_4\alpha_5 - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_5^2 - 2\alpha_1\alpha_4\alpha_5^2 \\
& + 2\alpha_2^2\alpha_4^2 - 2\alpha_2^2\alpha_4\alpha_5 + \alpha_2^2\alpha_5^2 - 2\alpha_2\alpha_4^2\alpha_5 + \alpha_4^2\alpha_5^2)(\alpha_1^2\alpha_2^2 - 2\alpha_1^2\alpha_2\alpha_4 + \alpha_1^2\alpha_3^2 - 2\alpha_1^2\alpha_3\alpha_4 + 2\alpha_1^2\alpha_4^2 - 2\alpha_1\alpha_2^2\alpha_3 \\
& - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_3^2 + 8\alpha_1\alpha_2\alpha_3\alpha_4 - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_4^2 - 2\alpha_1\alpha_3\alpha_4^2 + 2\alpha_2^2\alpha_3^2 - 2\alpha_2^2\alpha_3\alpha_4 + \alpha_2^2\alpha_4^2 - 2\alpha_2\alpha_3^2\alpha_4 + \alpha_3^2\alpha_4^2)(\alpha_1^2\alpha_2^2 \\
& - 2\alpha_1^2\alpha_2\alpha_3 + 2\alpha_1^2\alpha_3^2 - 2\alpha_1^2\alpha_3\alpha_5 + \alpha_1^2\alpha_5^2 - 2\alpha_1\alpha_2^2\alpha_5 - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_3^2 + 8\alpha_1\alpha_2\alpha_3\alpha_5 - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_5^2 - 2\alpha_1\alpha_3^2\alpha_5 + \alpha_2^2\alpha_3^2 \\
& - 2\alpha_2^2\alpha_3\alpha_5 + 2\alpha_2^2\alpha_5^2 - 2\alpha_2\alpha_3\alpha_5^2 + \alpha_3^2\alpha_5^2)(\alpha_1^2\alpha_2^2 - 2\alpha_1^2\alpha_2\alpha_3 + 2\alpha_1^2\alpha_3^2 - 2\alpha_1^2\alpha_3\alpha_4 + \alpha_1^2\alpha_4^2 - 2\alpha_1\alpha_2^2\alpha_4 - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_3^2 \\
& + 8\alpha_1\alpha_2\alpha_3\alpha_4 - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_4^2 - 2\alpha_1\alpha_3^2\alpha_4 + \alpha_2^2\alpha_3^2 - 2\alpha_2^2\alpha_3\alpha_4 + 2\alpha_2^2\alpha_4^2 - 2\alpha_2\alpha_3\alpha_4^2 + \alpha_3^2\alpha_4^2)(\alpha_1^2\alpha_2^2 - 2\alpha_1^2\alpha_2\alpha_4 + 2\alpha_1^2\alpha_4^2 \\
& - 2\alpha_1^2\alpha_4\alpha_5 + \alpha_1^2\alpha_5^2 - 2\alpha_1\alpha_2^2\alpha_5 - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_4^2 + 8\alpha_1\alpha_2\alpha_4\alpha_5 - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_5^2 - 2\alpha_1\alpha_4^2\alpha_5 + \alpha_2^2\alpha_4^2 - 2\alpha_2^2\alpha_4\alpha_5 + 2\alpha_2^2\alpha_5^2 \\
& - 2\alpha_2\alpha_4\alpha_5^2 + \alpha_4^2\alpha_5^2)(\alpha_1^2\alpha_2^2 - 2\alpha_1^2\alpha_2\alpha_5 + \alpha_1^2\alpha_3^2 - 2\alpha_1^2\alpha_3\alpha_5 + 2\alpha_1^2\alpha_5^2 - 2\alpha_1\alpha_2^2\alpha_3 - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_3^2 + 8\alpha_1\alpha_2\alpha_3\alpha_5 \\
& - 2\alpha_1\alpha_2\alpha_5^2 - 2\alpha_1\alpha_3\alpha_5^2 + 2\alpha_2^2\alpha_3^2 - 2\alpha_2^2\alpha_3\alpha_5 + \alpha_2^2\alpha_5^2 - 2\alpha_2\alpha_5\alpha_3^2 + \alpha_3^2\alpha_5^2)
\end{aligned}$$

Për I_6 shihni ??.

Janë katër invariante kryesore të kuintikëve, të shënuara J_4, J_8, J_{12}, J_{18} , të gradës 4,8,12 dhe 18, të tillë që secili $SL(2, \mathbb{F})$ - polinom invariant në b_0, \dots, b_5 është polinom J_4, J_8, J_{12}, J_{18} (shiko e.g. I. Schur, Vorlesungen ueber Invariantentheorie, Springer 1968). Për të përcaktuar J_4, J_8, J_{12} , na duhen disa madhësi ndihmëse

$$\begin{aligned}
A &= \frac{1}{100} (20b_4 - 8b_1b_3 + 3b_2^2), \\
B &= \frac{1}{100} (100b_5 - 12b_1b_4 + 2b_2b_3), \\
C &= \frac{1}{100} (20b_1b_5 - 8b_2b_4 + 3b_3^2)
\end{aligned}$$

dhe D, E, F, G të përkufizuara nga

$$(12) \quad \frac{1}{1000} \det \begin{bmatrix} 10u + 2b_1v & 2b_1u + b_2v & b_2u + b_3v \\ 2b_1u + b_2v & b_2u + b_3v & b_3u + 2b_4v \\ b_2u + b_3v & b_3u + 2b_4v & 2b_4u + 10b_5v \end{bmatrix} = Du^3 + Eu^2v + Fuv^2 + Gv^3$$

Atëherë,

$$\begin{aligned}
(13) \quad J_4 &= 5^3(B^2 - 4AC) \\
J_8 &= 2^5 \cdot 5^6 [2A(3EG - F^2) - B(9DG - EF) + 2C(3FD - E^2)] \\
J_{12} &= -2^{10} \cdot 5^9 \cdot 3^{-1} [4(3EG - F^2)(3FD - E^2) - (9DG - EF)^2]
\end{aligned}$$

Nga teoria klasike e invariantëve mund të shprehen d_1, \dots, d_6 si shprehje në J_4, J_8, J_{12} , një rezultat i shihni Berwick 1915; shihni [Kin96].

$$\begin{aligned}
d_1 &= -10J_4 \\
d_2 &= 35J_4^2 + 10J_8 \\
d_3 &= -60J_4^3 - 30J_4J_8 - 10J_{12} \\
d_4 &= 55J_4^4 + 30J_4^2J_8 + 25J_8^2 + 50J_4J_{12} \\
d_5 &= -26J_4^5 - 10J_4^3J_8 - 44J_4J_8^2 - 59J_4^2J_{12} - 14J_8J_{12} \\
d_6 &= 5J_4^6 + 20J_4^2J_8^2 + 20J_4^3J_{12} + 20J_4J_8J_{12} + 25J_{12}^2
\end{aligned}
\tag{14}$$

Pra koeficentët e $g(x)$ tani jepen si polinome në koeficentët e $f(x)$. Rezultatet e mësipërme i përmbledhim më poshtë:

Teorema 4. *Le të jetë dhënë $f(x)$ një polinom kuintik i pathjeshtueshëm me koeficentë në \mathbb{F} dhe d_1, \dots, d_6 të përkufizuara si më lart në koeficentët e $f(x)$. Atëherë $f(x)$ është i zgjidhshëm me radikale atëherë dhe vetëm atëherë kur*

$$g(x) = x^6 + d_1x^5 + \dots + d_5x + d_6$$

ka një rrënjë në \mathbb{F} .

REFERENCES

- [Gey74] W. D. Geyer, *Invarianten binärer Formen*, Classification of algebraic varieties and compact complex manifolds, 1974, pp. 36–69. Lecture Notes in Math., Vol. 412. [MR0374142](#)
- [Hil93] David Hilbert, *Theory of algebraic invariants*, Cambridge University Press, Cambridge, 1993. Translated from the German and with a preface by Reinhard C. Laubenbacher, Edited and with an introduction by Bernd Sturmfels. [MR1266168](#)
- [Kin96] R. Bruce King, *Beyond the quartic equation*, Birkhäuser Boston, Inc., Boston, MA, 1996. [MR1401346](#)
- [Sha20] T. Shaska, *Algjebra*, 2nd ed., RISAT, 2020.
- [SS16] Bedri Shaska and Tony Shaska, *Mësimdhënia e matematikës nëpërmjet problemeve klasike*, Albanian Journal of Mathematics **10** (2016), 47–80.

